



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**  
**- Kuvendi i Komunës-**  
**01Nr. 16-24602/12**  
**Kaçanik, 27.09.2012**

Në bazë të nenit 4 paragrafi 4.3 të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi procedurat e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike Nr. 15/2005, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27.09.2012 mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR SHPALLJEN E DISKUTIMIT PUBLIK TË ZONËS**  
**SË I DHE NJË PJESË TË ZONËS II URBANE DHE PLANET**  
**RREGULLUESE TË ZONAVE TURISTIKE**

**I.**

Me këtë Vendim, bëhet shpallja për shpallja për shqyrtimin publik të planit rregullues të zonës së I dhe një pjese të zonës së II urbane dhe planit rregullues të zonave turistike në territorin e komunës së Kaçanikut.

**II.**

Shqyrtimi publik i këtyre planeve bëhet pas publikimit të draft-dokumentit në afat prej 30 ditësh.

**III.**

Shpallja e shqyrtimit publik për draft-dokumentet e lartpërmendura duhet të përmbajë : ditën e fillimit, vendin dhe kohën e prezantimit publik, listën e dokumenteve që do të shqyrtohen nga publiku, propozimet, vërejtjet më shkrim dhe sugjerimet.

**IV.**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës dhe në tri gazetatat me tirazh më të madh.

**VI.**

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit,  
z. Xhelal Gashi